



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Rektori
Prof. dr. Ramë Vataj

Nr. ref. 01-26
Data: 01/03/2017

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr.04/L-037 si dhe dispozitat e nenit 47 paragrafi 1.3 të Statutit nr. 04-V-621, Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.01.2017, miratoi propozimet e njësive akademike dhe mori vendim për të shpallur:

KONKURS

PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK NË FAKULTETET E UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN

I. FAKULTETI I EKONOMISË:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhment Ndërkombëtar dhe Analiza Kuantitative në Biznes.
2. Një asistent për lëndët: Statistikë, Analiza Kuantitative në Biznes, Mikroekonomia dhe Makroekonomia.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Cloud Computing (Bsc.TIT sem VI –O, Bsc. SD sem V –O, Msc.sem II O), Sistemet e shpërndarjes (Bsc.SD sem VI –O), Parimet e Avancuara të Programimit (Msc.sem I – O), Teknologjia e Gjuhës (Msc. sem. II –Z).
2. Një asistent për lëndët: Modeli i Avancuar i të Dhënave dhe Bazat e të Dhënave (Msc.sem. I-O), Zhvillimi i Avancuar i Ueb-it (Bsc.sem. IV –O), Hyrje në Ueb Gjuhët dhe teknologji (Bsc. sem. II – Z), Sistemet e Bazës së të Dhënave (Bsc. sem. III –O), Data Mining (Msc. sem. II –O), Ueb Dizajn (Bsc. sem. III , -Z).

III. FAKULTETI I EDUKIMIT:

- Programi në gjuhën mësimore shqipe:

1. Një mësimdhënës për grup lëndësh në lëmin e Pedagogjisë.
2. Një asistent për gjuhë shqipe I, II dhe III

- Programi në gjuhën mësimore turke:

3. Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë I dhe II (programi fillor dhe parafillor) dhe Metodologji e Mësimit të Matematikës.

IV. FAKULTETI I FILOLOGJISË:

- Programi : Gjuhë dhe Letërsi Shqipe:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Fonetikë, Psikolinguistikë dhe Etimologji.

- Programi : Gjuhë dhe Letërsi Gjermane:

2. Një mësimdhënës për lëndët: Gramatikë e Gjuhës Gjermane I, Fonetikë e Fonologji dhe Leksikologji.

V. FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT:

- **Programi i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit:**
 1. Një mësimdhënës për lëndët: Silvikultura 1 (sem. III), Silvikultura 2 (sem. IV), Rivitalizimi i Pyjeve (sem.V) dhe Agropylltari (sem.IV).
 2. Një mësimdhënës për lëndët: Dendrometria (sem. III), Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve (sem. VI.), Mbrojtja e Pyjeve nga Zjarret (sem. VI), dhe Administrimi dhe Politikat e Resurseve Pyjore (sem.VI).
 3. Një mësimdhënës për lëndët: Ergonomia e Pyjeve (sem. V), Mekanizimi i Pyjeve (sem. IV), Prerja e Pyjeve, (sem.IV), dhe Inxhinjeringu i Pyjeve (sem. VI).
 4. Një asistent për grup lëndësh nga Biologjia.
- **Programi i Agrobiznesit:**
 5. Një mësimdhënës për lëndët: Ekonomiks (sem. I), Bazat e Financave, (sem. III), Menaxhimi Financiar (sem. IV) dhe Statistikë Biznesi (sem. III).
 6. Një asistent për grup lëndësh nga Agrobiznesi.

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Kandidatët të cilët aplikojnë për mësimdhënës duhet të kenë së paku gradën doktor i shkencave (dr.sc.) në fushën përkatëse.

Kandidatët të cilët aplikojnë për asistentë duhet të kenë të përfunduar studimet master ose magjistraturë në fushën përkatëse, të jenë jo më të vjetër se 28 vjet dhe të kenë notën mesatare jo më të ulët se 8 (tetë) në dy nivelet e studimeve (04-V-621:170-175).

Dokumentacioni për aplikim:

- Kërkesën dhe CV-në,
- Kopjen e diplomës përkatëse (për pozitën e mësimdhënësit diploma e tri niveleve të studimeve ndërsa për pozitën e asistentit për dy nivelet e studimit diplomën dhe pasqyrën e notave) të noterizuar.
- Ekstraktin e lindjes (origjinale) dhe kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë që nuk janë nën hetime ose nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale (origjinale).
- Kandidatët të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës duhet të paraqesin edhe vendimin e zgjedhjes së fundit.
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

Njohja e gjuhës angleze ose ndonjë gjuhë tjetër, të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar master jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pa kompletuar.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë dhe ueb-faqe respektivisht deri më datë 15.03.2017, në ora 15:00.

Paraqitja e dokumenteve bëhet në njësitë përkatëse akademike (te Sekretarët e Njësive Akademike), dhe kopjen elektronike në e mail-in zyrtar: rektorati@uni-prizren.com.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato që janë të pakompletuara nuk do të pranohen (nuk do të shqyrtohen nga komisioni përkatës).

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <http://www.uni-prizren.com>

Procedura e zgjedhjes së kandidatëve dhe e drejta e ankesës: pas hartimit dhe dorëzimit të raportit nga komisionet vlerësuese, raporti për secilin kandidat të paraqitur në konkurs do të publikohet në Buletinin e Universitetit, i cili qëndron në ueb-faqe të Universitetit pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e


publikimit. Buletinet do të hartohen për të gjitha pozitat dhe secilin kandidat të paraqitur në konkurs në mënyrë të veçantë. Raportet diskutohen dhe për to vendoset në Senat.

Ndaj vendimit të Senatit mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtrës, që shërben si instancë e parë e ankimit.

Ankesa duhet të bëhet më së largu 15 ditë nga dita e pranimit në dorëzim të vendimit të Senatit të UPZ-së me të cilin pala konsideron se i është mohuar e drejta për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim.

Ankesa duhet të dorëzohet në rektorat dhe do të shqyrtohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e përmbylljes së afatit të ankesave. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga komisioni do të propozohet për rishqyrtim dhe vendosje përfundimtare në nivel të Senatit të UPZ-së. Pala ankuese do të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin e Senatit pas shqyrtimit të ankesës.

Kundër vendimit përfundimtar të Senatit, kandidati në pajtim me nenin 185 paragrafi 3 pika 5 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti", mund të parashtrëjë ankesë në Këshillin Drejtues, si instancë e shkallës së dytë dhe e fundit brenda Universitetit.

Rektori

Prof.dr. Ramë Vataj

